



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. dokumentit: 21.12.1-2011-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË MINISTRISË SË**  
**ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL PËR VITIN E**  
**PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011**

**Prishtinë, Qershor 2012**

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	3
Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Hyrje.....	6
2 Opinioni i auditimit.....	7
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar.....	8
4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar.....	9
5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit.....	11
6 Menaxhimi financiar.....	12
6.1 Shpenzimet.....	12
6.2 Pasuritë.....	17
6.3 Trajtimi i borxheve.....	18
6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor.....	19
7 Kontrolli menaxherial.....	20
7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm.....	20
7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	21
8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e MAPL-së.....	23
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	24
Shtojca II: Gjendja e rekomandimi nga viti i kaluar.....	26

---

## Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OB	Organizatë Buxhetore
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
Rr F	Rregullat financiare të nxjerra nga Ministria e Financave
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
SP	Sekretar i Përgjithshëm
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKA	Zyrtar Kryesor Administrativ

---

## Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (më tutje MAPL) për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj se informacioni i shpalosur mbi pasuritë është jo i plotë.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse nuk ndikon në opinionin mbi P/F të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë se gatshme (**ISSAI 400: Opinion i Pakualifikuar me theksim të çështjes**).

Megjithatë, ne kemi identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendësi të raportit.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme të MAPL-së është dizajnuar në mënyrë të duhur për eliminimin e dobësive evidente, por nuk ka funksionuar si duhet.

Mangësitë në hartimin e PVF-ve edhe pse jo materiale për të ndikuar në opinionin e auditimit, kërkojnë adresim nga ana e menaxhmentit. MAPL nuk është duke kryer mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit të ekzekutimit të buxhetit në kategorinë e transfereve kapitale në mbështetje të komunave. Problemet me prokurimin, subvencionet dhe menaxhimin e pasurive janë çështje që tregojnë se MAPL duhet të përmirësoj më shumë llogaridhënien dhe transparencën për sa i përket veprimeve administrative.

Ne rekomandojmë Ministrin e MAPL-së të rishikoj dhe analizoj sistemin ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara. Kjo të bëhet për të rritur nivelin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë, në përputhje me detyrat dhe mandatet e përcaktuara.

Në lidhje me këtë ne rekomandojmë Ministrin e MAPL-së që të siguroj:

- Se Sekretari i Përgjithshëm rishikon dhe analizon implementimin e sistemit ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara. Mjeti i vetëvlerësimit për MFK-në mund të jetë pikënisje për këtë;

- 
- Më shumë vëmendje adresimit të rekomandimeve të dhëna nga ana jonë;
  - Planifikim më efikas të procesit buxhetor dhe krijim të parakushteve për ekzekutim të mirë të buxhetit për projekte përkatëse;
  - Përforcimin e kontrollit që nga planifikimi, monitorimi e deri te aprovimi i pagesave në mënyrë që të shmangen procedurat e shumta në fund të vitit;
  - Se PVF-të e organizatës përmbajnë shpalosjet e duhura sipas kërkesave të kornizës ligjore dhe informata mbi pasuritë;
  - Se ndryshimi i koeficientit të pagës në kontratë bëhet në bazë të gradimit dhe aprovimeve përkatëse nga MAP-i;
  - Proces më të mirë të prokurimit dhe pagesave;
  - Planifikimin, disponimin dhe zotimin e fondeve buxhetore para çdo hyrje në marrëveshje kontraktuale;
  - Se përmbushja e obligimeve ndaj OE-ve është kryer në përputhje me marrëveshjen;
  - Marrjen e masave që realizimi i punimeve të bëhet në përputhje me planin dinamik të përcaktuar në kontratë;
  - Shtimin e kontrolleve mbi avanset për udhëtime zyrtare dhe shfrytëzimin e tyre;
  - Shtimin e kontrolleve mbi planifikimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e subvencioneve për entitete publike dhe jo publike;
  - Se regjistrat e pasurisë janë të plota, të sakta dhe në përputhje me kornizën ligjore mbi menaxhimin e pasurive qeveritare si dhe të shpalosen pasuritë në PVF;
  - Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm dhe ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për implementimin e tyre; dhe
  - Rishikimin e proceseve dhe procedurave aktuale me qëllim të sigurimit të shërbimeve në mënyrë sa më efektive dhe efikase në pajtim me kërkesat e Menaxhimit të Financave Publike.

Menaxhmenti i MAPL-së i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi pasqyrat vjetore financiare për vitin 2011 dhe është zotuar që do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF-të e MAPL-së për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e MAPL-së të përgatis PVF-të sipas kërkesave të Rregullës Financiare nr. 07/2011 (RrF) dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë, të institucionit tuaj.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer auditimin e përkohshëm të MAPL-së. Gjatë asaj faze të procesit të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme, pasqyrat nëntëmujore dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Kemi këshilluar menaxhmentin. Kjo përfshinë edhe këshillat dhënë për pasqyra vjetore financiare. Memorandumi i auditimit, në rastin tonë është dorëzuar në Nëntor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona për auditimin e MAPL-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF-të e MAPL-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse PVF-të janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe RrF nr. 07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi PVF-të;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;

- Kemi kryer vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe testimin e tyre;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF-të 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF-të e MAPL-së, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

## 2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj se informacioni i shpalosur mbi pasuritë është jo i plotë.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse nuk ndikon në opinionin mbi P/F të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme (**ISSAI 400: Opinion i Pakualifikuar me theksim të çështjes**).

---

### 3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Në raportin e auditimit të PVF-ve për vitin 2010 janë dhënë rekomandime në tetë (8) fusha kryesore të MFK-së.

MAPL, ka aprovuar një Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve të ZAP-it. Deri në fund të auditimit tonë, dy rekomandime janë adresuar plotësisht, tri pjesërisht, dhe tri nuk janë adresuar ende.

Fushat ku rekomandimet ende nuk janë adresuar kanë të bëjnë me: shpalosjen e pasurive në pasqyrat financiare, pagesat për investime kapitale nga subvencionet dhe regjistrimi i shpenzimeve në kode jo adekuate.

Për një përshkrim të hollësishëm të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën 2.

#### **Konkluzion**

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona të mëhershme, ka ndikuar që në disa raste të njëjtat probleme të përsëriten edhe gjatë vitit 2011.

#### **Rekomandimi 1**

Ne rekomandojmë Ministrin e MAPL-së që të siguroj se:

- Sekretari i Përgjithshëm është duke i kushtuar më shumë vëmendje adresimit të rekomandimeve të dhëna.



## 4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar

Analiza e rezultatit në Pasqyrat Vjetore Financiare kundrejt Buxhetit të aprovuar tregon:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – aktuali ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2011 Të shpenzuara	2010 Të shpenzuara
Burimet e fondeve buxhetore. Gjithsej:	8,309,859	8,042,076	7,682,145	8,305,658
Granti i Qeverisë – Buxheti	8,309,859	8,040,676	7,680,745	8,239,812
Donacionet e jashtme	-	1,400	1,400	65,846

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë shihet se ekziston një zvogëlim nga buxheti fillestar në buxhetin final. Ato janë bërë me vendimin e qeverisë nr.01/43 datë 19.10.2011, për aprovimin e harmonizimeve të brendshme, kursimet dhe ndarjet e reja buxhetore.

Gjatë vitit 2011, MAPL ka shpenzuar 7,682,145€ ose 95.5% të buxhetit final.

**Tabela 2. Shpenzimi i fondeve sipas kategorive ekonomike-aktuali ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimi i fondeve sipas kategorive. Gjithsej:	8,309,859	8,042,076	7,682,145	8.305,658
Paga dhe Mëditje	699,919	776,980	726,375	610,831
Mallra dhe Shërbime	306,058	433,633	414,451	749,073
Shpenzimet Komunale	30,000	37,709	37,661	33,642
Subvencionet dhe Transferet	437,249	429,319	408,164	391,406
Investimet Kapitale	6,240,801	6,316,909	6,095,493	6,520,706
Rezervat	595,832	29,162	-	-

<sup>1</sup> Buxheti Final- buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Nga tabela vërehen ndryshime brenda dhe midis kategorive.

Ngritje e buxhetit final te Pagat dhe Mëditjet ka rrjedhë si rezultat i vendimit të qeverisë për fondin e kuadrove dhe pagave. Këto nuk janë ekzekutuar plotësisht për shkak të mos aprovimit të koeficientëve të pagave nga MAP.

Ngritja e buxhetit final për Mallra dhe Shërbime si dhe i Shpenzimeve Komunale ka ardhur si rezultat i lëvizjes së mjeteve nga Rezerva Kontingjente dhe Subvencioneve në këtë kategori.

Ngritja e buxhetit final në Investimet Kapitale ka ardhur si rezultat i alokimit të mjeteve nga rezerva në programin e Shpenzimeve Kontingjente.

Zvogëlimi në buxhetin final në lidhje me Subvencionet dhe Transferet, është rezultat i transferimit të mjeteve në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve.

Në buxhetin e vitit 2011, në programin e Shpenzimeve Kontingjente janë ndarë mjete prej 595,832€. Këto mjete janë ndarë për mbështetjen e komunave të reja. Alokimi i këtyre mjeteve është bërë me pëlqimin e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN-ICO).

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për kategorinë e “Rezervave” është zvogëluar për 566,670€ duke mbetur vetëm 29,162€. Nga shuma e reduktuar 296,670€ janë transferuar në komunitat e sapo themeluara, derisa pjesa tjetër në vlerë 270,000€ është shkurtim buxhetor i bërë me vendim të qeverisë

Ne kemi vërejtur se në tremujorin e fundit kishte rritje të shpenzimeve në subvencione dhe investime kapitale. Në këtë tremujor janë shpenzuar 90% e subvencioneve dhe 63% e investimeve kapitale.

### **Konkluzion**

Ne konkludojmë që MAPL ka arritur ta shpenzojë buxhetin brenda limiteve të përcaktuara për vitin 2011. Mirëpo, niveli i lartë i shpenzimeve për kategorinë e subvencioneve dhe kapitaleve në tremujorin e fundit lë të kuptojmë se MAPL nuk ka qenë efikas në përgatitjen e planifikimit dhe proceset e realizimit të buxhetit.

### **Rekomandimi 2**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së që të siguroj:

- Planifikim më efikas të procesit buxhetor dhe krijim të parakushteve për ekzekutim të buxhetit për projekte përkatëse. Kjo të bëhet duke përforcuar mbikëqyrjen e vazhdueshme të procesit të realizimit të buxhetit në raport me planifikimin paraprak të tij.

## 5 Pasqyrat vjetore financiare - Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit

Bazuar në kërkesat e LMPPP-së nr. 03/L-048 dhe Rregullën Financiare (RrF) nr.07/2011, ne kemi identifikuar çështjet në vijim:

- Pasqyrat Vjetore Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 31.01.2012 dhe janë dorëzuar në MF;
- PVF-të janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Ato janë dorëzuar në Thesar vetëm në gjuhën shqipe;
- Ne kemi rishikuar informatat e prezantuara në PVF-të e përgatitura nga MAPL para finalizimit të tyre. Nga kjo kemi vërejtur se MAPL, ka përgatitur PVF-të në pajtim me RrF nr. 07/2011, mirëpo disa mangësi të cilat nuk kanë ndikim material në opinion janë evidentuar në to.

Mangësitë e vërejtura për sa i përket cilësisë së tyre po i shpalosim në vijim:

- Tek Shënimi 2- Te ndarja e fondit të përgjithshëm është prezantuar vlera e buxhetuar e jo vlera e pranimeve siç kërkohet sipas rregullës së thesarit.
- Tek shënimi 30- Përmbledhja e pasurive jo financiare (me vlerë mbi 1000 €) në posedim të organizatës buxhetore (OB), nuk është prezantuar përmbledhja e pasurive jo financiare për vitin 2011. Pasuritë e blera nëpër vite prezantohen për atë vit por jo në mënyrë të përmbledhur.
- Tek shënimi 30- Përmbledhja e pasurive jo financiare (me vlerë nën 1000€) janë prezantuar vetëm blerjet e pasurive të vitit 2011, ndërsa nuk janë shpalosur pasuritë për vitin 2010 dhe 2009 si shënime krahasuese nëpër vite.

### Konkluzion

Marrë në përgjithësi PVF-të e MAPL-së janë në pajtim me kornizën ligjore për raportim financiar dhe Rr.F nr. 07/2011. Çështjet e theksuara më lartë nuk janë materiale dhe si rezultat nuk reflektojnë ndikimin e tyre në dhënien e opinionit për sa i përket PVF-ve. Sidoqoftë mungesa e shpalosjeve të pasurive duhet të adresohet në të ardhmen për të mundësuar kualitet më të lartë të raportimit financiar të Ministrisë.

### Rekomandimi 3

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së të siguroj që:

- Pasuritë dhe mangësitë tjera të raportuara janë adresuar në pasqyra nëntë mujore financiare.

## 6 Menaxhimi financiar

### 6.1 Shpenzimet

#### 6.1.1 Kompensimet (Pagat dhe Mëditjet)

Gjatë vitit 2011 në MAPL ishin të punësuar mesatarisht 129 punonjës, ndërsa shpenzimet për paga dhe mëditje ishin 726,375€.

Ne fillimisht kemi testuar 11 mostra dhe pastaj kemi zgjeruar testimin në 35 kontrata punësimi. Ne kemi vërejtur se pagesat nuk janë kryer sipas rregullave si në vijim :

Në të gjitha mostrat e testuara, ne kemi identifikuar ndryshimet në mes pagës bazë (në sistemin e pagesave) dhe koeficientit të përcaktuar në kontratë.

Ndryshimet bazohen në vendim të Sekretarit të Përgjithshëm i cili ka ndryshuar koeficientët e pagave për 35 punonjës në kontratat e tyre pa u ndryshuar pozitat e tyre. Si rezultat i kësaj është kërkuar dhe siguruar buxheti nga MF me vendim të Qeverisë.

Përkundër fakteve më lartë, lëvizja e koeficientëve (ngritja) nuk është aprovuar nga MAP-i si institucion qeveritar përgjegjës për sistemin e pagave dhe miratimin e gradimit në tërë shërbimin civil të Kosovës.

#### **Konkluzion**

Ngritja e koeficientëve të pagave për punonjësit pa miratimet e nevojshme , tregon se MAPL nuk ka bashkëpunuar në mënyrë të mjaftueshme me MAP-in.

#### **Rekomandimi 4**

Rekomandojmë ministrin e MAPL-së që të siguroj se:

- Koeficientët e pagës në kontratë të jenë në përputhje me gradën (koeficientin) e përcaktuar në sistemin e pagesave (Payroll) si dhe ndryshimet në koeficient të aprovohen nga MAP-i.

---

## 6.1.2 Prokurimi

Në vitin 2011, MAPL përmes procedurave të prokurimit ka shpenzuar gjithsej 6,338,086€. Në auditimin e kryer, kemi përzgjedhur 44 mostra nga pagesat e ndodhura në SIMFK në vlerë prej 1,740,359€ dhe shtatë mostra nga kontratat e prokurimit në vlerë prej 253,392€.

MAPL, mban raporte direkte me Komunitat e Kosovës, duke ofruar shërbime për to me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe funksionalitetit në raport me qytetarët.

Buxheti i MAPL-së përdoret për zhvillimin e kornizës ligjore, ngritjen e infrastrukturës rrugore dhe investime tjera kapitale në Komunitat e Kosovës, e sidomos për ato të reja.

Kuvendi i ndanë një vlerë totale të fondeve për investime infrastrukturore. Pastaj, komunitat konkurojnë me projekte të veçanta me qëllim të përfitimit të Subvencioneve nga MAPL për tërë ose një pjesë të projektit.

MAPL përzgjedhë projektet dhe nënshkruan marrëveshje mirëkuptimi me komunitat për financimin e tyre. Në secilën marrëveshje parashihet se procedurat e prokurimit dhe mbikëqyrjes së projekteve i realizojnë komunitat, ndërsa investimet e realizuara pas finalizimit bëhen pasuri e komunës.

Komunitat duhet t'i kompletojnë disa dokumente si (kontratat, vendimet e komisionit mbikëqyrës, raportet mbi kryerjen e punimeve, faturat origjinale, etj). Pas kompletimit të dokumentacionit, MAPL bën ekzekutimin e pagesës direkt te Operatorët Ekonomik (OE) të kontraktuar.

Testet tona të zhvilluara kanë rezultuar me disa të gjetura si në vijim:

### Moskryerja e obligimeve ndaj OE-ve

Te lënda "Ndërtimi i rrjetit elektrik në fshatin Boletin" të komunës së Zveqanit, kemi vërejtur se MAPL-ja ka paraparë në marrëveshje me komunën që financimin ta bëjë në vlerë prej 250,000€, ndërsa OE-ja ishte paguar në vlerë 214,686€.

MAPL, përveç mungesës së buxhetit, nuk ka qenë në gjendje të na ofroj arsye tjetër bindëse për dështimin në pagesën e këtyre obligimeve.

Kjo tregon se MAPL ka hyrë në obligime pa fondet e duhura për përmbushjen e tyre.

Për trajtimin e mëtutjeshëm të diferencës si obligim i mbetur në këtë rast, MAPL dhe komuna e Zveqanit nuk kanë ndonjë marrëveshje të shkruar se kush do të bartë obligimin.

Situata të tilla mund të krijojnë rrethana të trajtimit të mëtutjeshëm gjyqësor dhe më pas ta rrezikojnë edhe më shumë buxhetin e organizatës me krijimin e gjobave tjera pos vlerës bazë të borxhit.

#### Vonesa në realizimin e punimeve

Tek lënda "Rregullimi i kanalizimit në Budrik" në vlerë 62,359€, afati për përfundimin e punimeve është 70 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, ndërsa është vonuar afërsisht një vit. Kontrata është nënshkruar me datën 30 Gusht 2010, ndërsa punimet janë realizuar me 05 Korrik 2011. Me këtë rast Ministria nuk ka aplikuar penale për vonesat në realizimin e punimeve.

#### Mungesa e zotimit të mjeteve

Tek lënda „Karburante për vetura“ në vlerë 3,215€, është bërë zotimi i mjeteve pas pranimit të faturave nga OE e jo paraprakisht para hyrjes në marrëveshje kontraktuale.

#### Evidentimi i shpenzimeve në kode jo përkatëse

Tek lënda "Furnizim me Kamera" në vlerë 6,492€, shpenzimet janë evidentuar në kodin furnizim për zyre e jo në kodin ekonomik përkatës (blerja e pajisjeve me vlerë mbi 1000€ tek investimet kapitale).

#### Përzgjedhja e OE-së si i përgjegjshëm pa i plotësuar kriteret e përcaktuara

Tek lënda "Furnizim me pajisje të TI-së" në vlerë 22,963€, njëri nga OE-të është vlerësuar si i përgjegjshëm. OE ka sjellë vetëm tri referenca, por duke mos i bashkangjitur kontratat përkatëse, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

### **Konkluzioni**

Ne konkludojmë se në mostrat e testuara, MAPL nuk ka zhvilluar kontrolle të mjaftueshme për sa i përket investimeve kapitale, veçanërisht tek procedurat e realizimit të pagesave sipas marrëveshjes. Ka munguar një proces i mirëfilltë i mbikëqyrjes së projekteve të shpërndara në komuna dhe kjo ka shkaktuar probleme edhe për sa i përket prokurimit dhe ekzekutimit të projekteve me kohë. Mungesa e fondeve për përmbushjen e obligimeve në marrëveshjet me komunat, tregon se MAPL nuk ka planifikuar mirë buxhetin dhe ka hyrë në obligime pa mbulesë.

**Rekomandimi 5**

Rekomandojmë ministrin e MAPL-së të siguroj:

- Shtimin e kontrolleve me synim që punimet në projekte të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar, në të kundërtën të merren masa për penalizmin e punëkryesve.
- Planifikimin, disponimin dhe zotimin e fondeve buxhetore para çdo marrëveshje kontraktuale për realizim të projekteve;
- Se përmbushja e obligimeve ndaj OE-ve është kryer në përputhje me marrëveshje. Të ri rregullohet marrëveshja paraprake midis palëve për të siguruar përmbushjen e obligimeve;
- Shtimin e kontrolleve në vlerësimin e tenderëve, si dhe sigurimin se anëtarët e komisionit përkatës trajtojnë kriteret ashtu siç janë kërkuar në DT; dhe
- Se të gjitha shpenzimet janë evidentuar sipas kodeve adekuate (natyrës së shpenzimit).

### 6.1.3 Blerjet tjera

#### Aprovimi i avanseve për udhëtime zyrtare duke i anashkaluar procedurat

Tek lënda "Vizitë zyrtare e delegacionit të MAPL-së" në Kroaci, kemi vërejtur se në kuadër të delegacionit kanë qenë edhe dy gazetar të RTK-së.

Për dy gazetarët nuk ka ndonjë dokument të miratuar për angazhimin gjatë vizitës së tyre në Kroaci. Shpenzimet për gazetar gjatë kësaj vizite janë paguar nga buxheti i MAPL-së në vlerë prej 1,500€, ku janë përfshirë: udhëtimi, fjetja dhe ushqimi.

#### Vonesë në mbylljen e avanseve nga udhëtimet zyrtare

UA-2004/7 për udhëtime zyrtar kërkon që avanset të mbyllen brenda 15 ditëve pas kthimit nga udhëtimi.

Në dy raste kemi vërejtur se ka pasur vonesa në mbylljen e avanseve:

Te lënda "Vizitë zyrtare e delegacionit të MAPL-së" në SHBA, kemi vërejtur se delegacioni ka qëndruar në udhëtim zyrtar nga 16-24 Tetor 2011, ndërsa mbyllja e avansit është bërë me datën 05 Janar 2012, respektivisht gati dy muaj me vonesë.

Te lënda "Vizitë zyrtare e delegacionit të MAPL-së" në Shqipëri, delegacioni ka qëndruar në udhëtim zyrtar nga 07-09 Korrik 2011. Ndërsa mbyllja e avansit është bërë në Mars 2012, respektivisht tetë (8) muaj me vonesë.

## Konkluzioni

Ne konkludojmë se MAPL ka nevojë të forcojë proceset në lidhje me udhëtimet. Kjo vërehet në neglizhencën e saj për të mbyllur me kohë avanset dhe dështimin për të siguruar në të gjitha rastet dëshmi të duhura për të arsyetuar paranë e dhënë. Mangësi të tilla ndikojnë në shpenzimin e fondeve në mënyrë jo adekuate dhe për qëllime jo efikase.

### Rekomandimi 6

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së të siguroj:

- Dokumentim të shkruar i cili i përcakton qëllimet dhe arsyet për pjesëmarrjen e stafit jo shërbyes civil në përbërje të delegacionit të paguar me fonde të BK-së. Dokumentimi të përfshijë agjendat dhe ftesat përkatëse; dhe
- Mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare brenda 15 ditëve pas kthimit nga udhëtimi.

## 6.1.4 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere është 429,319€, ndërsa janë shpenzuar 408,164€ ose 95% të buxhetit të planifikuar. Nga kjo ne kemi testuar 10 mostra në shumë prej 371,251€.

Ne kemi vërejtur të gjeturat në vijim:

### Dhënie e subvencioneve përmes modulit jo përkatës (blerjeve)

Subvencionet e dhëna për përfituesit publik dhe jo publik, në SIMFK duhet të evidentohen në modulën e aprovimeve.

Në katër pagesa në vlerë prej 29,743€ subvencionet nuk janë evidentuar në modulën përkatës, por në modulën e blerjeve. Kjo është në kundërshtim me procedurat për dhënie të subvencioneve.

### Dhënie e subvencioneve për investime kapitale

Sipas rregullave të Thesarit, subvencionet nuk mund të jepen me qëllim të shpenzimit për investime kapitale.

Në dy raste kemi vërejtur se subvencionet u janë dhënë komunave për realizimin e projekteve në investime kapitale e këto janë:

Tek lënda "Asfaltimi i rrugës lokale në Karaqevë" në vlerë 150,000€; si dhe



Te lënda "Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dimcë Komuna e Hanit të Elezit" në vlerë 100,000€.

Për shkak të planifikimit jo të mjaftueshëm për subvencione, një shumë e konsiderueshme e buxhetit të Ministrisë ka mbetur i pa shpenzuar. Si rrjedhojë, menaxhmenti i ministrisë kishte vendosur të financojë projekte kapitale.

### **Konkluzioni**

Ne konkludojmë se proceset vendimmarrëse dhe kontrolli i brendshëm në MAPL nuk ka funksionuar si duhet për të siguruar menaxhim efikas të subvencioneve. Planifikimi nuk mbështetet në kërkesa dhe nevoja konkrete, si dhe nuk ka procedura të qarta për dhënien e subvencioneve.

Mungesa e një kontrolli të brendshëm të duhur për sa i përket subvencioneve ndikon që ato të shpenzohen në jo pajtueshmëri me Rregullën Financiare.

### **Rekomandimi 7**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së të siguroj që:

- Realizimi i subvencioneve do të kalojë përmes procedurave të aprovimeve, ndërsa evidentimi i tyre në SIMFK do të bëhet në modulën e aprovimeve;
- Subvencionet planifikohen në pajtueshmëri me kërkesat dhe nevojat si dhe kriteret për dhënien e tyre hartohen për të siguruar se dhënia e subvencioneve bëhet vetëm për kategoritë e përcaktuara me kornizë ligjore.

## **6.2 Pasuritë**

### **6.2.1 Trajtimi i pasurive kapitale dhe jo-kapitale**

Lista e pasurive të MAPL-së e marrë nga Thesari përmban një vlerë neto të pasurive prej 6,415,484€.

Ne kemi rishikuar regjistrin kontabël, regjistrin e përgjithshëm të pasurisë dhe menaxhimin e tyre në pajtim me U.A nr.21/2009 - Mbi Regjistrimin dhe Menaxhimin e Pasurive Qeveritare.

Projektet e investimeve kapitale të financuara nga MAPL-ja nëpër komuna përkatëse evidentohen në regjistrat kontabël të komunave.

Nga testimet tona kemi vërejtur disa mangësi për sa i përket menaxhimit dhe evidentimit të pasurive, si:

- Regjistri i përgjithshëm i pasurive nuk i përmban të gjitha elementet që kërkohen me U.A.nr.21/2009. Në regjistër, kemi vërejtur se mungojnë barkodi dhe numri serik;
- Në një rast blerja e pajisjes Outdoor Megapixel dhe IR camera me vlerë 1,267€ nuk është evidentuar në regjistrin kontabël (SIMFK); dhe
- Njehsimi fizik (inventarizimi) i pasurisë është bërë për vitin 2011, siç kërkohet me U.A. Mirëpo nuk është bërë harmonizimi i të dhënave nga regjistri i pasurisë me raportin e inventarizimit.

### **Konkluzion**

Mungesa e evidencave të plota mbi pasurinë tregon dobësi në menaxhimin e tyre. Kjo tregon se MAPL nuk ka zhvilluar kontrole të mjaftueshme. Mos harmonizimi i të dhënave nga regjistri i përgjithshëm i pasurisë me raportin e inventarizimit do të ndikonte në mos evidentimin e diferencave në mes këtyre regjistrave. Si rrjedhojë, cilësia e raporteve për pasuritë nuk është e mjaftueshme.

### **Rekomandimi 8**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së të siguroj:

- Se regjistrat e pasurisë janë të plota dhe të sakta. Të gjitha pasuritë me vlerë mbi 1000€ të evidentohen në regjistrin kontabël (SIMFK); dhe
- Harmonizimin e të dhënave midis regjistrit të përgjithshëm të pasurisë dhe raportit të inventarizimit, në mënyrë që të gjenden diferencat si dhe të merren masat e nevojshme për azhurnimin e atij regjistri.

## **6.3 Trajtimi i borxheve**

Obligimet e pa kryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishin në vlerë 52,215€.

Obligimet e pa kryera, kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të reprezentacionit, furnizim me derivate, mirëmbajtjen e automjeteve, mëditje etj.

Arsyeja kyçe, për mos kryerjen me kohë të obligimeve, sipas zyrtarëve përgjegjës ka qenë mungesa e fondeve të zotuara dhe vonesat në pranimin e faturave.

### **Konkluzion**

Planifikimi jo i mirë i fondeve të duhura dhe mungesa e kontroleve për të siguruar pranimin me kohë të faturave ka ndikuar që MAPL të hyjë në obligime pa pasur mjete të

zotuar. Hyrja në obligime paraqet vështirësi në realizimin e projekteve në vitin pasues, kjo për arsye se pagesa e obligimeve të bartura zvogëlon buxhetin e vitit aktual.

#### **Rekomandimi 9**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së që të siguroj:

- Parashikime më të mira dhe monitorim të vazhdueshëm të fondeve të përcaktuara për kategori të shpenzimeve .

## 6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

MAPL, ka përmbushur obligimet aktuale për raportim të jashtëm, si:

- Gjatë vitit 2011, MAPL ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF-së;
- Ka dorëzuar raportin e performancës për vitin 2010 në Thesar me 26.08.2011, edhe përkundër faktit se RrF-05/2011 kërkon që brenda një muaji pas pranimit nga OB të P/F të audituara të dorëzohet ky raport tek Ministri i Financave, por jo më vonë se 15 Gusht.
- Ka dorëzuar me kohë Pasqyrat Nëntëmujore Financiare;
- Ka dorëzuar me kohë në ZAP planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
- Ka dorëzuar raportet mbi borxhet në MF; dhe
- Ka dorëzuar planin preliminar dhe final të prokurimit për vitin 2011, si dhe ka dorëzuar me kohë në APP.

#### **Konkluzioni**

MAPL ka përmbushur në masë të madhe kërkesat për raportim të jashtëm. Përjashtim nga kjo është vonesa e dorëzimit të raportit të performancës, siç kërkohet me RrF-05/2011 për Raportim Vjetor të OB.

#### **Rekomandimi 10**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së që të siguroj:

- Dorëzimin e raporteve vjetore të performancës brenda periudhës së përcaktuar me ligj.

## 7 Kontrolli menaxherial

### 7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Në përgjithësi MAPL ka një sistem të dizajnuar të kontrollit të brendshëm që determinon si duhet mjedisin e kontrollit. Të gjeturat e identifikuara tregojnë se ky sistem nuk ka funksionuar si duhet.

MAPL ka të strukturuar nivelet e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies brenda organizatës.

Aktivitetet e kontrollit janë të shpërndara në segmentet e duhura të organizatës. Ndarja e detyrave dhe kontrollet janë të ndërtuara brenda saj.

Kontrollet ende nuk janë duke operuar për të siguruar funksionim të mirë, transparent dhe konkurrent në disa fusha.

Procesi i prokurimit, ai i menaxhimit dhe i evidentimit të pasurive ende përcillet me mangësi. Ministria gjithashtu përballet me dobësi në realizimin e marrëveshjeve të përcaktuara me komunat për realizimin e investimeve kapitale dhe procedurat e dhënies së subvencioneve për entitete publike dhe jo publike. MAPL, edhe më tutje ka probleme me planifikim dhe mbikëqyrje të buxhetit, që rezulton në mjaft obligime të bartura në vitin vijues.

#### **Konkluzioni**

Sistemi i kontrollit të brendshëm nuk është duke funksionuar si duhet në të gjitha segmentet. Duhet theksuar edhe më tutje se problemet për sa i përket prokurimit, menaxhimit të pasurive dhe obligimeve janë çështje kyçe në të cilat MAPL-ja duhet të fokusohet për të përmirësuar situatën.

#### **Rekomandimi 11**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së që të siguroj:

- Përforsim të kontrollit të brendshëm në fushat me dobësi të theksuara, identifikim të shkaqeve që kanë shkaktuar ato dobësi dhe veprime konkrete për t'i parandaluar ato.

---

## 7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

MAPL ka të themeluar NjAB, që përbëhet nga Drejtori i Auditimit të Brendshëm dhe një zyrtar.

NjAB ka përgatitur një plan vjetor dhe strategjik të auditimit për 2011-2013.

Gjatë vitit, NjAB kishte arritur t'i kryej pesë auditime të bazuara në planin vjetor si dhe dy me kërkesën e menaxhmentit.

Në planin vjetor janë paraparë të realizohen 7 (shtatë) auditime si dhe shërbimet e konsulencës për auditime preventive. Auditimi ynë ka konstatuar se, kjo njësi nuk kishte përmbyshur plotësisht planin vjetor të auditimit.

Gjithashtu, NjAB nuk ka hartuar statutin e njësisë e cila do të ndihmonte në realizimin e objektivave dhe qëllimeve të NjAB-së.

NjAB, gjatë vitit ka hartuar raporte tre mujore, raportin vjetor për auditimet e kryera dhe aktivitetet e AB-së, dhe i ka dorëzuar ato në Njësinë Qëndrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm.

Të gjitha raportet e auditimit janë përcjellë me gjetje dhe rekomandime.

Gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së, nuk janë përcjellur me plane konkrete të veprimit nga departamentet përkatëse.

MAPL ka formuar komitetin e auditimit më 31.01.2011, në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve. Komiteti më vonë është riformuluar me vendim të Menaxhmentit të datës 30 Maj 2011. Komiteti i auditimit kishte hartuar statutin e Komitetit në Shtator të vitit 2011.

Gjatë vitit 2011 ai kishte mbajtur gjithsej tri takime të rregullta, ku është analizuar puna e NjAB-së si dhe implementimi i rekomandimeve.

### **Konkluzion**

Marrë në përgjithësi, krahasuar me vitet paraprake, gjatë vitit 2011 shihet një progres sa i përket fokusimit në auditimin e proceseve në vitin aktual, si dhe rritjen e rolit të mbikëqyrjes së Komitetit të Auditimit. Megjithatë, ministria ende nuk ka bërë sa duhet për të hartuar plane konkrete për të përcaktuar veprimet për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB-ja.

**Rekomandimi 12**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL-së që të siguroj:

- Hartimin e statutit të NJAB-së me qëllim të rritjes së funksionalitetit të saj;
- Se NJAB përmbush planin e auditimit, dhe punën e saj ta fokusoj në mbikëqyrjen e menaxhimit financiar dhe kontroleve në përputhje me procedurat përkatëse të nxjerra nga MF; dhe
- Hartimin e një plani të veprimit i cili përcakton veprime konkrete për adresimin e rekomandimeve të NJAB-së.

## 8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e MAPL-së

Konkluzioni ynë është se menaxhmenti i MAPL-së kishte një sistem të dizajnuar të kontrollit të brendshëm. Mirëpo, në disa raste MAPL nuk ka arritur që t'i implementoj tërësisht këto kontrole. Mangësitë në hartimin e PVF-ve jo aq materiale për të ndikuar në opinionin e auditimit kërkojnë adresim nga ana e menaxhmentit.

Të gjeturat tona gjithashtu tregojnë se MAPL nuk është duke kryer mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit të ekzekutimit të buxhetit në kategorinë e transfereve kapitale në mbështetje të komunave.

Problemet me prokurimin, subvencione dhe menaxhimin e pasurive janë çështje që tregojnë se MAPL duhet të përmirësoj më shumë llogaridhënien dhe transparencën për sa i përket veprimeve administrative.

Gjithashtu vonesat e ndryshme, qoftë për sa i përket pagesave, mos zotimit të mjeteve me kohë, mbylljes së avanseve me vonesë, etj. kanë ndikuar edhe në realizimin e planeve të MAPL-së në mënyrë jo efikase dhe jo efektive.

### **Rekomandimi i përgjithshëm**

Ne rekomandojmë Ministrin e MAPL-së të siguroj:

- Që Sekretari i Përgjithshëm rishikon dhe analizon implementimin e sistemit ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, në mënyrë që të funksionalizoj llogaridhënien dhe përgjegjësinë; dhe
- Rishikimin e proceseve dhe procedurave aktuale me qëllim të sigurimit të shërbimeve në mënyrë sa më efektive dhe efikase në pajtim me kërkesat e Menaxhimit të Financave Publike.

## Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.



---

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;

b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinionin në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca II: Gjendja e rekomandimi nga viti i kaluar

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Plotësisht të implementuara	Pjesërisht të adresuar	Të pa adresuara
V. Pasqyrat Vjetore Financiare	Shpalosja e pasurive në pasqyrat financiare			Nuk janë marrë masat e duhura. Rekomandimi nuk është adresuar.
VI.1 Shpenzimet	1. Pagesat për investime kapitale nga subvencionet. 2. Regjistrimi i shpenzimeve në kode jo adekuate			Nuk janë marrë masat e duhura. Rekomandimi nuk është adresuar.
VI.1.2 Blerjet tjera	Tejkalimi i shpenzimeve për telefoninë fikse	Janë marrë masa dhe rekomandimi është plotësuar.		
1.3 Kompensimi (Pagat dhe Mëditje)	Azhurnimi jo i duhur i dosjeve të personelit siç janë mos nënshkrimi në pagat mujore	Janë marrë masa dhe rekomandimi është plotësuar		
1.4 Subvencione dhe Transfere	Pagesa e projekteve nga kategoria e subvencioneve			Nuk janë marrë masat e duhura. Rekomandimi nuk është adresuar.
VI.2. Pasuritë kapitale dhe jo	1.Regjistri gjithë përfshirës i objekteve dhe pajisjeve si dhe të		1. Numërimi fizik i pasurive është kryer në	

kapitale	njëjta të shpalosen në P/F. 2. Numërimi fizik mbi ekzistencën e pasurive dhe barazimin e rezultateve të numërimit me të dhënat kontabël dhe regjistrin e pasurisë.		periudhën e përcaktuar ,por nuk janë harmonizuar të dhënat e regjistrin të pasurisë me raportin e inventarizimit. 2. Ekziston një progres në evidentimin e pasurisë por nuk është bërë shpalosja si duhet në P/F.	
VII.1 Sistemi i kontroleve të Brendshme				
VII.2 Auditimi i brendshëm	1. NJAB gjatë përgatitjes së planit vjetor të fokusohet në proceset e vitit aktual. 2. Rekomandimet e NjAB-së të adresohen nga menaxhmenti me plane konkrete të veprimit nga departamentet përkatëse. 3. Fuqizimi i KA-së për mbikëqyrjen e duhur të planeve dhe rezultateve të auditimit.		Auditori i brendshëm është fokusuar në auditimin e proceseve në vitin aktual, si dhe është fuqizuar komiteti i auditimit . Mirëpo nuk ka progres sa i përket planeve konkrete të veprimit nga departamentet për implementimin e rekomandimeve të NjAB.	